



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2019:267505

Datë: 23.06.2021

Numri i dokumentit: 01915887



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**P.nr.1013/19**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me procesmbajtësen-praktikanten Saranda Keqolli në çështjen penale kundër të pandehurit A. Z. për shkak të veprës penale “Vjedhje e pyllit” nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorit të shtetit PP.II.nr.2998/19 të dt. 15.11.2019, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, më datë **28.05.2021**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit PP.II.nr.2998/19 të dt. 15.11.2019.** Andaj gjykata komforë dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

### **URDHËR NDËSHKIMOR**

#### **I PANDEHURI**

**A. Z.** nga i ati R., e ema M. e gjnis T. i lindur me dt...nga fshati M. komuna e Vushtrris me numër personal, ....., i martuar shqipërisht, shtetas i R. Kosoves.

## **ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** me dt.15.09.2018 rreth orës 15:00, ne pyllin shoqëror qe menagjohet nga Drejtoria per Ekonomi, Bujqesi ,Pylltari dhe Zhvillim Rural ne pronësi komunale e fsh. M.-Vushtrri, ne vendin e quajtur “Duke dal nga pylli”, pa leje me qellim vjedhje ka prere dhe ka marrur 64 trungje te llojit “Shkoze”, me diametër 10-12cm, me gjatësi 9m, me vëllim prej 1.93m<sup>3</sup>, ne vlerë te demit, prej 293.76.

**-me këtë ka kryer veprën penale: “Vjedhje e pyllit” nga neni 358 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata–komformë dispozitave të neneve 4, 7,17, 41, 43, 46, 73, te KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365 e 366 të KPPK-së, shqipton.

## **DËNIM ME GJOBË**

**Me të cilën të pandehurit A. Z.** i caktohet dënimi me gjobë në shumën prej **100€ (njëqind euro)**, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të zëvendësoi dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20€, për një ditë të kaluar me burg (neni 46 par 3 KPRK dhe neni 365 par 2 KPPRK).

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të kompensimit të demit, të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim – Pylltaria, zyra në Vushtrri, t’ia paguaj shumën prej 293.76. €.

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor te paguaje **20(njëzet) euro**.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.2998/19 të dt. 15.11.2019 , kundër të pandehurit A. Z. për shkak të veprës penale “Vjedhje e pyllit” nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhrin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë se shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri ligjvënësi ka parashikuar dënimi me gjobë ose burgim deri 1 (një) vit, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të qështjes e komfor nenit 493 të KPPK-së. Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e dt.03.09.2019 i Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim i Komunës së Vushtrrisë sektori i pylltarisë, procesverbali mbi demin e shkaktuar i dt. 15.09.2018.

Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.1 KPRK-ës, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, gjykata morri parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, intezitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë qeshtje penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, i akuzuari ka pasur sjellje korrekte pas kryerjes se veprës penale.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejt dhe i ligjshëm, se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale e të pandehurit dhe me intezitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Së këndejmi me praninë e të gjitha këtyre rrethanave nuk ka pasur vend që të pandehurit ti shqiptohet një dënim më të butë ose me të rënd.

Andaj gjykata vlerësoj se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qellim i dënim në vështtrim me nenin 41 të KPPK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që ne të ardhmen i pandehuri të këtë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata, mundet të ashpëron dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi kompensimin e dëmit palës së dëmtuar gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushall u maur në kuptim nenit 450 par.2 nen paragrafi 1 dhe 6 të KPPK-së.

## **GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI**

**Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal**

**P.nr. 1013/19, të datës 28.05.2021**

**Procesmbajtësja**  
Saranda Keqolli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Ferki Xhaferi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afate prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim.